

V E N D I M
Nr.81, datë 15.7.2003

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR, KONKLUZIONEVE DHE
REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR TË NGRITUR ME
VENDIMIN NR.72, DATË 17.3.2003**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 20, 21 dhe 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratohet raporti përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor të Kuvendit, të ngritur me vendimin nr.72, datë 17.3.2003 “Për ngritjen e Komisionit hetimor të Kuvendit për hetimin e veprimtarisë së Qeverisë për transparencën e procesit të firmave piramidale në bazë të ligjit nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Raportit përfundimtar i bashkëlidhet mendimi i pakicës, sipas nenit 21 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi